

URDHËR
Nr. 480, datë 25.6.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Arian Kraja, Sekretar i Përgjithshëm:

a) Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjyimit, duke përfshirë: kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjyimit të kësaj çështjeje, si dhe t’i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga z. Arian Kraja, Sekretar i Përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

b) Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

c) Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për procedurat e koncesioneve dhe partneritetin publik privat me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

d) Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

e) Të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

f) Të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit.

g) Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen na z. Arian Kraja, Sekretar i Përgjithshëm, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

4. Ngarkohet z. Arian Kraja, Sekretar i Përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 342, datë 23.4.2018, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu